



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 196/26 Dt. 04.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, dispozitive të Udhëzimit Administrativ (MASHT) 02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e udhëtimit zyrtar të Haxhere Gavazaj dhe Nexhat Maçkaj -zyrtarë komunal të DKA-së në Komunën e Prizrenit, nga data 05 maj 2026 deri 07 maj 2026, me qëllim të vizitës së nxënësve maturan të cilët ndodhen në ekskursion në Durrës të Republikës së Shqipërisë. Shkollat (nxënësit maturan të) të cilët ndodhen në ekskursion janë nga: SHMLM "Luciano Motroni" së bashku me shkollën e muzikës, Gjinnazi "Gjon Buzuku", Gjinnazi "Remzi Ademaj", dhe IAAP "Ymer Prizreni". Kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar i të lartcekurve, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjeve, si dhe për shpenzime të paparashikuara për të lartcekurit, konform, akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

